



South East European Network
for Professionalization of Media

KAPACITETET E KUFIZUARA DHE MUNGESA E QËNDRUESHMËRISË

Vetërregullimi i mediave në Kosovë

Florent Spahija

MEDIA JONË:

Një projekt i shoqërisë civile për të nxitur edukimin për median dhe aktivizmin, kundër polarizimit, në dobi të dialogut



South East European Network
for Professionalization of Media

MEDIA JONË:

Një projekt i shoqërisë civile për të nxitur edukimin për median dhe aktivizmin, kundër polarizimit, në dobi të dialogut

KAPACITETET E KUFIZUARA DHE MUNGESA E QËNDRUESHMËRISË **Vetërregullimi i mediave në Kosovë**

Autor: Florent Spahija

Redaktore, hulumtuese kryesore rajonale: Brankica Petković

Përkthyes: Qerim Ondozi

Lektor: Imer Mushkolaj

Dizajn: Špela Kranjec

Botues:

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës

Fondacioni "Mediacentar", Sarajevë

Kosovës, tetor 2023



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova



*Botimi u krye me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian.
Përmbajtja e tij është përgjegjësia e vetme e autorit dhe botuesve
dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pozicionin e Bashkimit Europian.*

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
I. HYRJE	5
II. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM	6
III. KODET E ETIKËS PËR RAPORTIMIN PROFESIONAL TË MEDIAVE	8
3.1. KODET VETËRREGULLUESE TË ETIKËS	9
3.1.1. Kodi i Etikës për Mediat e Shkruara dhe Online	9
3.1.2. Standardet profesionale dhe parimet etike të gazetarisë në programet e Radio Televizionit të Kosovës	10
3.2. KODET LIGJËRISHT TË DETYRUESHME	10
3.2.1. Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale	10
3.2.2. Mbulimi medial gjatë zgjedhjeve	11
IV. KORNIZA VETËRREGULLUESE	12
V. SFIDAT NË VETËRREGULLIMIN E MEDIAVE ONLINE	15
VI. SFIDAT NË VETËRREGULLIMIN E TRANSMETUESIT PUBLIK	17
VII. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET	18
LITERATURA DHE BURIMET	20
RRETH AUTORIT	22

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kosova ka një sistem funksional vetërregullues, por ka sfida në zbatimin e tij. Këshilli i Mediave nuk ka qëndrueshmëri financiare dhe ka një staf të vogël për shkak të të cilit kapacitetet e tij janë të kufizuara. Sfida të tjera përfshijnë vetërregullimin e video përmbajtjeve të publikuara nga mediat online dhe vetërregullimin e përmbajtjeve të krijuara nga përdoruesit. Përveç kësaj, ka shumë prodhues të ndryshëm të përmbajtjes online për shkak të të cilave është e vështirë të bëhet dallimi mes online mediave autentike dhe prodhuesve të përmbajtjes joprofesionale.

Ka pasur shqetësime në lidhje me përpjekjet e qeverisë së Kosovës për të zbatuar rregullim më të rreptë të sferës online, përfshirë mediat online të cilat mund të paraqesin kërcënime për ekzistencën e organit vetërregullues.

Ekziston nevoja për të përmirësuar mekanizmin vetërregullues në Kosovë, për të gjetur modelin e qëndrueshëm të financimit për Këshillin e Mediave dhe për të promovuar punën e organit vetërregullues. Këshilli i Mediave duhet të informojë vazhdimisht publikun për mundësinë e paraqitjes së ankesave në lidhje me shkeljet e mundshme të Kodit nga mediat online dhe të shtypura në Kosovë dhe duhet të bashkëpunojë ngushtë me autoritetin rregullator kombëtar – Komisionin e Pavarur të Mediave – për të rritur kapacitetet e tij në marrjen e vendimeve për video përmbajtjen e mediave online. Mediat duhet të marrin pjesë vazhdimisht në mbledhjet e Kuvendit të Këshillit dhe të kontribuojnë në punën e Këshillit të Mediave. Mediat duhet t'i trajtojnë vazhdimisht gazetaret në respektimin e Kodit të Etikës, qoftë në shtyp, online ose në transmetim. Ato duhet të promovojnë përdorimin e Kodit të Mediave të Shkruara dhe Online në redaksitë e tyre.

Transmetuesi i shërbimit publik gjithashtu e ka kodin e vet të etikës (“Standardet Profesionale dhe Parimet Etike”), i cili është i detyrueshëm për stafin e tij, por nuk është përditësuar. Radio Televizioni i Kosovës duhet të iniciojë procedurën e rishikimit dhe përditësimit të kodit të tij të brendshëm, duke përfshirë përditësimet më të fundit nga zhvillimet në legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar.

Ka një sistem funksional vetërregullues, por ka sfida në zbatimin e tij.

I.

HYRJE

Raporti në vijim ofron një pasqyrë të kodeve të etikës për mediat në Kosovë dhe funksionimin e mekanizmave vetërregullues. Raporti përqendrohet kryesisht në rolin e Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës dhe në Kodin e Etikës së Mediave të Shkruara dhe Online, por gjithashtu jep një pasqyrë të kornizës rregulluese në Kosovë, duke përfshirë punën e Komisionit të Pavarur të Mediave. Raporti bazohet në shtatë intervista me ekspertë të mediave, juristë të mediave, profesorë të gazetarisë, gazetarë dhe redaktorë, analiza të kodeve vetërregulluese dhe rregullatore dhe literaturë dytësore. Qëllimi ishte të sigurohet një pasqyrë gjithëpërfshirëse e sfidave në vetërregullimin në Kosovë dhe të jepen rekomandime për përmirësimin e kornizës vetërregulluese. Që nga pandemia COVID-19, nuk ka pasur më gazeta ditore të shtypura në Kosovë, vetëm versionet e tyre onilne, për shkak të të cilave raporti kryesisht shikon sfidat me të cilat përballen në vetërregullimin e mediave online.

Vlerësimi i përgjithshëm

II.

VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM

Kosova ka korniza funksionale vetërregulluese dhe rregullatore, të ngjashme me vendet e tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor. Autoriteti kryesor përgjegjës për rregullimin e programeve të radios dhe televizionit është Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM). Kushtetuta e Republikës së Kosovës thotë se KPM-ja është autoritet i pavarur me përgjegjësi të rregullimit të frekuencave të transmetimit, lëshimit të licencave për transmetuesit publikë dhe privatë dhe krijimit dhe zbatimit të politikave të transmetimit¹. Stacionet televizive dhe të radios janë të detyruara t'i përmbahen Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve të Mediave, të licencuar nga KPM-ja. Përkundër funksionimit të sistemit rregullator, të intervistuarit theksojnë rëndësinë e forcimit të vetërregullimit në transmetuesit televizivë dhe radio.²

Raportet flasin për një rënie të standardeve profesionale veçanërisht të mediave online, ndërsa janë ngritur shqetësime për ndërhyrjen politike në rregullator dhe në media.

Mediat e shkruara dhe online, nga ana tjetër, funksionojnë nën kornizën vetërregulluese – Këshilli i Mediave të Shkruara i Kosovës – që është themeluar në vitin 2005 me ndihmën e OSBE-së. Liria e shprehjes, e drejta e qytetarëve për t'u informuar plotësisht dhe respektimi i Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës janë themelet mbi të cilat është themeluar Këshilli i Mediave të Shkruara, thuhet në webfaqen e Këshillit. Qëllimi i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës është të mbrojë qytetarët nga informacioni i rremë dhe gazetarët nga ankesat e pabaza.³ Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës ka Kodin e vet të Etikës për Mediat e Shkruara dhe Online⁴, si dhe rregullat e procedurës dhe pranimit të ankesave. Për t'iu përgjigjur sfidave të reja në sferën digjitale dhe të gazetarisë, Kodi u rishikua disa herë, me rishikimin e fundit në vitin 2022.⁵

1 Kosovo 2.0, Cohu! Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (2015), Liria e Shprehjes, Mediave dhe Informacionit në Kosovë Një Vlerësim i Bazuar në Treguesit e Këshillit të Evropës për Mediat në një Demokraci, Prishtinë, Në dispozicion në: https://crd.org/wp-content/uploads/2018/12/Freedom_of_Expression_Media_and_Information_in_Kosovo_529396.pdf.

2 Intervistë me Artan Mustafën, ligjërues në Kolegjin UBT në Departamentin e Sociologjisë, ish-kryeredaktor dhe gazetar për shumë vite, 1 qershor.2023, Prishtinë.

3 Rreth Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës më shumë informata në dispozicion në: <http://presscouncil-ks.org/rreth-nesh/>.

4 Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, (2022), "Kodi i Etikës për Mediat e Shkruara dhe Online", është në dispozicion në: <http://presscouncil-ks.org/kodi-i-mediave-te-shkruara-dhe-online/>.

5 Ibid.

Përveç këtyre dy mekanizmave, ekziston një Ligj i veçantë për Transmetimin Publik për Radio Televizionin e Kosovës⁶. Transmetuesi i shërbimit publik gjithashtu ka kodin e vet të etikës⁷, i cili është i detyrueshëm për stafin e tij.⁸Përveç kësaj, të gjitha mediat janë të detyruara t'u përmbahen rregullave për mbulimin medial gjatë zgjedhjeve, siç përcaktohen me Ligjet për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, gjë që vlen edhe për zgjedhjet lokale.⁹

Megjithatë, ka shumë çështje dhe shqetësime mbi efektivitetin e kornizave rregullatore dhe vetërregulluese dhe nivelin e raportimit profesional të mediave në Kosovë. Raportet flasin për një rënie të standardeve profesionale veçanërisht të mediave online, ndërsa janë ngritur shqetësime për ndërhyrjen politike në rregullator dhe në media¹⁰. Përveç Kodit të Etikës për Mediat e Shkruara dhe Online, kodet dhe rregulloret profesionale të mediave nuk janë përditësuar, pavarësisht tendencave dhe sfidave të shumta të reja me të cilat përballlet gazetaria dhe në sferën online, dhe standardet e vendosura në BE, për shembull për platformat e shpërndarjes së videove.

Ka pasur shqetësime në lidhje me përpjekjet e qeverisë së Kosovës për të zbatuar rregullim më të rreptë të sferës online, përfshirë mediat online. Organizatat profesionale të mediave, përfshirë Këshillin e Mediave dhe Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës, reagues kundër iniciativës së Komisionit për Qeverisje Lokale, Zhvillim Rajonal dhe Media të Kuvendit të Kosovës për të prezantuar legjislacionin që do të përfshinte mediat online. Në deklaratën e Këshillit të Mediave të publikuar në vitin 2021 shkruhej se nismat për kontrollin dhe vlerësimin e etikës për mediat e shkruara dhe ato online nga shteti janë të dëmshme dhe nuk u ndihmojnë mediave dhe gazetarëve¹¹. Ata gjithashtu deklaruan se shkeljet e standardeve etike duhet të vlerësohen nga komuniteti i mediave dhe ekspertët e mediave.

Ka pasur shqetësime në lidhje me përpjekjet e qeverisë së Kosovës për të zbatuar rregullim më të rreptë të sferës online, përfshirë mediat online. Organizatat profesionale të mediave, përfshirë Këshillin e Mediave dhe Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës, reagues kundër iniciativës.

6 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 7 / 27 prill 2012, Prishtinë, https://cps.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/09/LAW_NO_04_L-046_ON_RADIO_TELEVISION_OF_KOSOVO.pdf

7 Radio Televizioni i Kosovës, (2015), "Standardet profesionale dhe parimet etike të gazetarisë në programet e Radio Televizionit të Kosovës", në dispozicion në: https://www.rtklive.com/pages/files/standardet_profesionale.pdf.

8 Intervistë me Besnik Boletinin, kryetarin e bordit të RTK-së, gazetar për shumë vite në Preporter, 14 qershor.2023, Prishtinë.

9 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, (2008), Prishtinë, Ligji nr. 03/I-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2544>.

10 Mehmeti J., (2022), "Barometri vibrant i informacionit", në dispozicion në https://www.irex.org/VIBE_2022_Kosovo.

11 Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, (2021), "Kumtesat për Shtyp" në dispozicion në: <https://www.facebook.com/KMSHKosove/posts/4013604132015842/2>

Shih gjithashtu: Kusari F., (2018), "Ligji për media: i panevojshëm", në dispozicion në: <https://sbunker.net/article10-bllogje-tematike/89706/ligji-per-media-i-panevojshem/>

III.

KODET E ETIKËS PËR RAPORTIMIN PROFESIONAL TË MEDIAVE

Ekzistojnë dy kode vetërregulluese për mediat në Kosovë. Kodi kryesor vetërregullues për mediat e shkruara dhe online është Kodi i Etikës për Mediat e Shkruara dhe Online të Kosovës që përcakton standardet për raportimin profesional të mediave për mediat e shkruara dhe online. Një kod tjetër vetërregullues janë Standardet Profesionale dhe Parimet Etike të Gazetarisë në Programet e Radio Televizionit të Kosovës që janë të detyrueshme për stafin që punon në transmetuesin publik. Përveç kodeve vetërregulluese, ekzistojnë ligje të detyrueshme që rregullojnë raportimin e mediave gjatë zgjedhjeve dhe Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Tabela 1: **KODET VETËRREGULLUESE**

EMRI I KODIT	I PËRGJITHSHËM OSE SPECIFIK	VITI I MIRATIMIT DHE RISHIKIMI EVENTUAL	I ZBATUAR NË PRAKTIKË	ORGANI QË MONITORON ZBATIMIN E KODIT DHE SHQYRTON ANKESAT
Kodi i Etikës për Mediat e Shkruara dhe Online	Mediat e shkruara dhe online	Rishikimet e fundit në vitin 2022	Po	Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës është organi i vetëm vetërregullues.
Standardet profesionale dhe parimet etike të gazetarisë në programet e Radio Televizionit të Kosovës	Transmetuesi publik	Rishikimet e fundit në vitin 2015	Po	Bordi dhe menaxhmenti i Radio Televizionit të Kosovës

Tabela 2: **KODET E DETYRUESHME LIGJËRISHT**

EMRI I KODIT	I PËRGJITHSHËM OSE SPECIFIK	VITI I MIRATIMIT DHE RISHIKIMI EVENTUAL	I ZBATUAR NË PRAKTIKË	ORGANI QË MONITORON ZBATIMIN E KODIT DHE SHQYRTON ANKESAT
Kapitulli 7, Mediat gjatë fushatës zgjedhore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë	Të gjitha mediat	Ligji u miratua në vitin 2009	Po	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, KPM, Gjykata
Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.	Stacione televizive dhe radio	Rishikimet e fundit në vitin 2016	Po	Komisioni i Pavarur i Mediave

3.1. KODET VETËRREGULLUESE TË ETIKËS

3.1.1. Kodi i Etikës për Mediat e Shkruara dhe Online

Kodi i Etikës për Mediat e Shkruara dhe Online të Kosovës përcakton standardet për raportimin profesional të mediave dhe rregullat e tij janë profesionalisht dhe moralisht të detyrueshme për redaktorët dhe gazetarët e mediave online dhe të shkruara. Kodi aktual përfshin 12 kapituj të nxjerrë nga standardet ekzistuese ndërkombëtare të praktikës gazetarore, të cilat duhet të zbatohen edhe për video-storiet e publikuara në mediat online. Rregullat e saj përfshijnë standardet në lidhje me raportimin e së vërtetës, parandalimin e lajmeve të rreme dhe gjuhës së urrejtjes, mbrojtjen e të miturve, privatësinë dhe burimet, të drejtën për t'u përgjigjur, rregullat rreth reklamimit dhe sponsorizimit¹². Meqenëse Këshilli i Mediave është organ vetërregullues, ai nuk ka autoritetin të sanksionojë shkeljet e Kodit, por rekomandon përmirësime dhe edukon mediat në lidhje me shkeljet e identifikuara.

Kodi është rishikuar në vitin 2022 dhe ndryshimet në krahasim me versionin nga viti 2019 përfshijnë dispozita për lajmet e rreme dhe rregulla në lidhje me video dhe audio përmbajtjen e publikuar nga mediat online. Për shembull, në Kod thuhet se mediumi nuk duhet të përdorë, shfaqë ose publikojë në asnjë formë teksti, audio, video ose dokumente të manipuluar (të manipuluar) dhe se falsifikimi i fotografive, imazheve, audios ose videos dhe dokumenteve është i ndaluar, përfshirë përdorimin e tyre për qëllime dezinformimi.

Kodi i Etikës për Mediat e Shkruara dhe Online të Kosovës përcakton standardet për raportimin profesional të mediave dhe rregullat e tij janë profesionalisht dhe moralisht të detyrueshme për redaktorët dhe gazetarët e mediave online dhe të shkruara.

12 Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, (2022), "Kodi i Etikës për Mediat e Shkruara dhe Online", në dispozicion në: <http://presscouncil-ks.org/kodi-i-mediave-te-shkruara-dhe-online/>

3.1.2. Standardet profesionale dhe parimet etike të gazetarisë në programet e Radio Televizionit të Kosovës

Dokumenti i titulluar Standardet Profesionale dhe Parimet Etike të Gazetarisë në Programet e Radio Televizionit të Kosovës (RTK)¹³ përcakton standardet profesionale për punonjësit e transmetuesit të shërbimit publik. Kodi, i hartuar në vitin 2015 dhe i përditësuar në vitin 2016, përcakton standardet për raportimin medial për televizionin, radion dhe portalin online të transmetuesit publik¹⁴. Kodi ka 57 faqe dhe është më i detajuar dhe përshkruar se kodet e tjera, dhe kështu mund të shërbejë si një udhëzues gjithëpërfshirës për standardet profesionale dhe parimet etike edhe në media të tjera. Në përmbajtjen e tij ndjek shembullin e Standardeve Profesionale të RTV Sllovenisë¹⁵. Vlerësimi i kodeve të etikës në mediat e shërbimit publik në Ballkanin Perëndimor, i kryer nga drejtoresha e Federatës Evropiane të Gazetarëve Renate Schroeder, në kuadër të një projekti të financuar nga BE-ja, shpjegon se kodi i sjelljes i Radio Televizionit të Kosovës është pjesë e kontratave të punës për gazetarët. Megjithatë, vlerësimi i referohet intervistave me gazetarët e RTK-së, duke theksuar se “shumica e gazetarëve të intervistuar pretendojnë se kodi është zbatuar dobët në praktikë nga gazetarët e RTK-së dhe kjo është për shkak të ndërhyrjes aktive politike drejtpërdrejt në politikën redaktoriale”.¹⁶ Në vlerësim autorja arrin në përfundimin se “pavarësisht një vlerësimi shumë pozitiv në lidhje me përmbajtjen e kodit, njohurive të aktorëve, përfshirë gazetarët, kodi nuk gjen zbatimin e duhur për të siguruar që të pengohet ndërhyrja nga politika”.¹⁷

Kodi është rishikuar në vitin 2022 dhe ndryshimet në krahasim me versionin nga viti 2019 përfshijnë dispozita për lajmet e rreme dhe rregulla në lidhje me video dhe audio përmbajtjen e publikuar nga mediat online.

Kodi i sjelljes i Radio Televizionit të Kosovës është pjesë e kontratave të punës për gazetarët. Megjithatë, kodi është zbatuar dobët në praktikë për shkak të ndërhyrjes aktive politike drejtpërdrejt në politikën redaktoriale.

3.2. KODET LIGJËRISHT TË DETYRUESHME

3.2.1. Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale

Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës¹⁸ është miratuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave gjatë vitit 2000 dhe ka pësuar disa rishikime, me ndryshimin e fundit të bërë në vitin 2016. Kodi është ligjërish i detyrueshëm dhe shkeljet e tij mund të rezultojnë në gjoba të lëshuara nga KPM-ja. Kodi rregullon përmbajtjen e publikuar nga stacionet

13 Radio Televizioni i Kosovës, (2015), Prishtinë, “Standardet profesionale dhe parimet etike të gazetarisë në programet e Radio Televizionit të Kosovës”, në dispozicion në: https://www.rtklive.com/pages/files/standardet_profesionale.pdf.

14 Intervistë me Besnik Boletin, kryetarin e bordit të RTK-së, gazetar për shumë vite në Preporter, 14 qershor.2023, Prishtinë.

15 Shih kodin e RTV Slovenia në: <https://www.rtvlo.si/strani/professional-standards/17>.

16 Renate Schroeder, European Federation of Journalists (2018), “Examining and Assessing Editorial Guidelines/Codes of Conducts in the Public Service Media of the Western Balkans”, në dispozicion në: <https://europeanjournalists.org/wp-content/uploads/2018/07/PSM-Editorial-Guidelines-Report-EFJ-Renate-Schroeder.pdf>.

17 Ibid.

18 Komisioni i Pavarur i Mediave, (2016), “Kodi i etikës për ofruesit e shërbimeve mediatike në Republikën e Kosovës”, në dispozicion në: <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/1476189555.8908.pdf>.

televizive dhe radio, ndalon përmbajtjen e dëmshme, vulgare dhe ofenduese, nxitjen e urrejtjes, përcakton standardet për paanshmërinë dhe saktësinë, mbrojtjen e privatësisë dhe fëmijëve dhe të drejtën për t'u përgjigjur.

3.2.2. Mbulimi medial gjatë zgjedhjeve

Kosova ka mekanizma specifikë rregullues gjatë cikleve zgjedhore dhe mediat duhet të respektojnë Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës¹⁹. Kapitulli 7 përcakton rregullat e mbulimit medial gjatë zgjedhjeve, veçanërisht në lidhje me reklamat politike dhe ofrimin e mbulimit të drejtë dhe të barabartë për të gjithë kandidatët gjatë zgjedhjeve. Ai përcakton rregullat e përgjithshme për reklamat politike në programet televizive dhe radiofonike dhe për reklamat politike me pagesë për mediat e shkruara.

Si publiku ashtu edhe partitë politike mund të paraqesin ankesa në një organ të posaçëm që mblidhet gjatë zgjedhjeve, Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës²⁰, i cili përcakton nëse është shkelur Ligji Zgjedhor, duke vepruar si gjykatë e shkallës së parë. Megjithatë, kjo rregullore nuk e pengon palën t'i drejtohet organit vetërregullues, Këshillit të Mediave në rastet e shkeljeve nga mediat online dhe të shkruara, ose KPM-së në rastet që përfshijnë televizionin ose radion. Gjatë cikleve zgjedhore, mediat transmetuese monitorohen rregullisht bazuar në rregullat e vendosura, dhe atyre u kërkohet të paraqesin raporte të rregullta në KPM, dhe madje të mbajnë regjistrime të veçanta të transmetimit.²¹

19 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, (2009), Kapitulli VIII Media gjatë fushatës zgjedhore nga neni 47 deri në nenin 53, në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2544>.

20 Faqja zyrtare e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, në dispozicion në: <https://pzap.rks-gov.net/>.

21 Ligji për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, (2009), Kapitulli VIII Media gjatë fushatës zgjedhore
Neni 53 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. "Komisioni i Pavarur i Mediave do të sigurojë që mediat të mbajnë një regjistër për të regjistruar kohën e transmetimit, dhe ekspozimin e mediave të tjera, për reklama të paguara dhe jo të paguara, të aktiviteteve të fushatës së secilit subjekt politik. Regjistri duhet të masë të gjithë treguesit përkatës të ekspozimit, veçmas për secilën Subjekt Politik, në mënyrën e përcaktuar nga rregullat e KPM-së ", në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2544>.

IV.

KORNIZA VETËRREGULLUESE

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës është organ vetërregullues për mediat e shkruara dhe online. Ai pranon ankesat e qytetarëve në lidhje me shkeljet e pretenduara të Kodit të Etikës për Mediat e Shkruara dhe Online. Një organ i posaçëm brenda Këshillit të Mediave, Kuvendi, i përbërë nga përfaqësues të gazetave, portaleve të lajmeve, periodikëve, agjencive të lajmeve dhe blogjeve, mbledhet çdo muaj dhe merr vendime për ankesat për shkeljet e mundshme të Kodit²². Sekretariati luan rol koordinues dhe lehtësues mes palëve të jashtme dhe Këshillit të Mediave, duke përcjellë njëkohësisht ankesa ose parashtrësia në Këshillin e Mediave, si dhe duke informuar palët për vendimet e marra nga Këshilli i Mediave në lidhje me shkeljet e Kodit të Etikës. Këshilli i Mediave të Shkruara mund ta miratojë ankesën në tërësi, ta miratojë pjesërisht, ta refuzojë, t’ia referojë KPM-së për kompetencë, ose të deklarojë i paftë në trajtimin e ankesës ose pretendimit nga pala. Qytetarët mund të përdorin një formular online për të paraqitur ankesë.²³

Tabela 3: MEKANIZMAT VETËRREGULLUES

EMRI I ORGANIT/ MEKANIZMIT VETËRREGULLUES	VITI I THEMELIMIT	THEMELUESIT	BURIMI I FINANCIMIT	AKTIV/ PASIV
Këshilli i Mediave	2005	Mediat	Donatorët e huaj 95%, dhe pagesat e anëtarësimit 5%	Aktiv

²² Rreth Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës: <http://presscouncil-ks.org/rreth-nesh/>.

²³ Ibid.

Gjatë vitit 2022, janë trajtuar 167 ankesa të ndryshme²⁴. Roli i Këshillit të Mediave në promovimin e standardeve profesionale është njohur në komunitetin e mediave. Sipas kryeredaktorit të Telegrafi.com, është thelbësore që mediat jo vetëm të bëhen anëtare të Këshillit, por edhe të marrin pjesë aktive në vendimet²⁵ e Këshillit të Mediave, të ndjekin vendimet e Këshillit dhe të shmangin shkeljet e Kodit²⁶. Sipas drejtorit të Këshillit të Mediave, përveç organizimit dhe trajnimit të gazetarëve për Kodin, mediat duhet të publikojnë vazhdimisht informata në lidhje me Kodin e Etikës për Mediat e Shkruara dhe Online në rrjetet e tyre sociale dhe të bëjnë publike vendimet e marra në lidhje me shkeljet e kodit.²⁷

Roli i Këshillit të Mediave në promovimin e standardeve profesionale është njohur në komunitetin e mediave.

Roli i Këshillit të Mediave është gjithashtu i rëndësishëm në rastet e shpifjes. Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes thotë se para paraqitjes së padisë, një person i dëmtuar do të ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për të zbutur çdo dëm të shkaktuar nga shprehja dhe do të kërkojë korrigjimin e asaj shprehjeje nga personi që dyshohet se ka shkaktuar dëmin. Ligji thotë se veprime të tilla mund të përfshijnë kërkimin e një zgjidhjeje nga botuesi i një shprehjeje shpifëse ose fyese dhe paraqitjen e një kërkesë pranë ndonjë organi të përshtatshëm rregullator (Komisioni i Pavarur i Mediave) ose organi vetërregullues (Këshilli i Mediave të Shkruara)²⁸. Vendimet e Këshillit mund të jenë vendimtare në përcaktimin e rasteve të shpifjes dhe gjykatat gjithashtu mund të kërkojnë mendimin e Këshillit të Mediave si një Amicus Curie.²⁹

Vendimet e Këshillit mund të jenë vendimtare në përcaktimin e rasteve të shpifjes dhe gjykatat gjithashtu mund të kërkojnë mendimin e Këshillit të Mediave si një Amicus Curie.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës aktualisht ka 50 anëtarë³⁰ të rregullt nga gazetatat, portalet e lajmeve dhe agjencitë e lajmeve. Këshilli i Mediave ka një staf shumë të vogël prej 3 zyrtarësh me kohë të plotë (drejtori ekzekutiv, sekretari i këshillit dhe zyrtari i projektit), një këshilltar ligjor të jashtëm të angazhuar në shërbime ligjore dhe një zyrtar financiar me kohë të pjesshme. Këshillit të Mediave i mungon një zyrtar i marrëdhënieve me publikun, zyrtar i financave, një këshilltar i përhershëm ligjor, zyrtarë të projektit dhe menaxherë të projektit, zyrtarë që do të ndihmonin Sekretariatit në marrjen e ankesave dhe kërkesave nga palët³¹. Mungesa e stafit është veçanërisht e dukshme në ndërveprimin e saj me publikun, sepse në mes të vitit 2022, KMSHK-ja nuk ka qenë në gjendje të paraqesë vendimet e saj në webfaqen e saj³². Të

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës aktualisht ka 50 anëtarë të rregullt nga gazetatat, portalet e lajmeve dhe agjencitë e lajmeve.

24 Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, (2023), "Infografika për të gjitha rastet gjatë vitit 2022", në dispozicion në: <https://facebook.com/photo/?fbid=235032702216397&set=a.200032859049715>.

25 Intervistë me Muhamet Hajrullahun, kryeredaktor në Telegrafi.com dhe ligjërues universitar në gazetari, 4 qershor 2023, Prishtinë.

26 Ibid.

27 Intervistë me Imer Mushkolajn, drejtor ekzekutiv i KMSHK-së, gazetar dhe redaktor për një kohë të gjatë në media të ndryshme, 8 qershor 2023, Prishtinë.

28 Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, (2006), në dispozicion në: http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L65_en.pdf.

29 Intervistë me Flutura Kusari, Këshilltare e Lartë Ligjore në Qendrën Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias ECPMF, 7 qershor 2023, Prishtinë.

30 Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, "Dokumenti i listës së anëtarëve", në dispozicion në: <http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2022/01/Annex-2-List-of-Media-Members-PCK-copy.pdf?fbclid=IwAR2RkHryQHlqlqdbmiBCBBkbhWgVuj75crUyGLpwYwXtIHNgIzPEBMgwUgk>.

31 Ibid.

32 Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, "Tabela e publikimeve të vendimeve nga KMSHK-ja", në dispozicion në: <http://presscouncil-ks.org/vendimet/>.

intervistuarit theksojnë se është e rëndësishme që vendimet të përpunohen.³³ Komunikimi me publikun përmes televizionit, mediave të shkruara, radios, rrjeteve sociale, gjithashtu ka qenë i rrallë. Me staf të kufizuar dhe një ngarkesë të konsiderueshme pune, shumica e publikut në Kosovë nuk janë në dijeni të ekzistencës së Këshillit dhe një organi ku ata mund të paraqesin ankesa. Sipas një eksperti të mediave, nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të edukuar publikun për ekzistencën e një organizate të tillë.³⁴

“Pavarësisht rritjes së numrit të ankesave sipas statistikave, unë ende besoj se ekziston një potencial i madh për të paraqitur edhe më shumë ankesa bazuar në atë që shoh çdo ditë në portalet e lajmeve... E vetmja pjesë që mungon duket të jetë ndërgjegjësimi mes palëve të prekura se një organizatë e tillë ekziston dhe roli që ajo luan³⁵.” (Kusari).

Numri i vogël i punonjësve në Këshillin e Mediave është pasojë e drejtpërdrejtë e mungesës së fondeve dhe mospagesës së anëtarësisë nga anëtarët³⁶. Aktualisht, 95% e financimit të Këshillit vjen nga donatorë të huaj përmes projekteve lokale ose rajonale, dhe vetëm 5% financohet nga anëtarësimi³⁷. Raporti financiar i Këshillit të Mediave për vitin 2020, për shembull, tregon se vetëm 13 nga 45 anëtarë që ishin anëtarë të Këshillit atë vit paguan tarifën vjetore të anëtarësimit prej 300 eurove³⁸. Organizatat e shoqërisë civile dhe ekspertët e mediave kanë propozuar që një përqindje nga buxheti i përgjithshëm i Radio Televizionit të Kosovës t’i ndahet Këshillit të Mediave.

“Ky buxhet do të ofronte mbështetje dhe qëndrueshmëri për KMSHK-në, duke mundësuar rritjen e burimeve njerëzore dhe teknologjike për KMSHK-në. Buxheti gjithashtu do të nënkuptonte që mediat do t’i dërgonin redaktorët ose kryeredaktorët e tyre në mbledhjet e KMSHK-së për të vendosur mbi ankesat e paraqitura nga palët, duke rritur kështu besimin e publikut në paraqitjen e ankesave.³⁹” (Kusari).

Përveç punës për të vendosur mbi shkeljet e Kodit të Mediave të Shkruara dhe Online, Këshilli i Mediave organizon edhe aktivitete të tjera. Për shembull, Shkolla e Etikës së Gazetarisë⁴⁰ organizohet çdo vit, gjatë së cilës trajtohen dilemat etike, përfshirë ato me të cilat gazetarët e rinj mund të përballen gjatë punës së tyre.

33 Intervistë me Imer Mushkolajn, drejtor ekzekutiv i KMSHK-së, gazetar dhe redaktor për një kohë të gjatë në media të ndryshme, 8 qershor 2023, Prishtinë.

34 Ibid.

35 Intervistë me Flutura Kusarin, Këshilltare e Lartë Ligjore në Qendrën Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias ECPMF, 7 qershor.2023.

36 Intervistë me Imer Mushkolajn, drejtor ekzekutiv i KMSHK-së, gazetar dhe redaktor për një kohë të gjatë në media të ndryshme, 8 qershor 2023, Prishtinë.

37 Ibid.

38 Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, (2020), “Raporti Financiar 2020”, qaset drejtpërdrejt dhe nuk mund të gjendet në webfaqen të KMSHK-së.

39 Intervistë me Flutura Kusarin, Këshilltare e Lartë Ligjore në Qendrën Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias ECPMF, 7 qershor 2023.

40 Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, (2023), “Shkolla e Etikës së Gazetarisë”, në dispozicion në: <http://presscouncil-ks.org/kmskhk-organizon-shkollen-e-etikes-se-gazetarise-2/>.

Mungesa e stafit është veçanërisht e dukshme në ndërveprimin e saj me publikun, sepse në mes të vitit 2022, KMSHK-ja nuk ka qenë në gjendje të paraqesë vendimet e saj në webfaqen e saj.

Numri i vogël i punonjësve në Këshillin e Mediave është pasojë e drejtpërdrejtë e mungesës së fondeve dhe mospagesës së anëtarësisë nga anëtarët.

V.

SFIDAT NË VETËRREGULLIMIN E MEDIAVE ONLINE

Pavarësisht përpjekjeve dhe punës së vazhdueshme nga Këshilli i Mediave, ekspertët e mediave dhe punonjësit e mediave pranojnë se ka raste kur media të caktuara e shpërfillin plotësisht kodin ose e shkelin qëllimisht për të gjeneruar më shumë klikime dhe, rrjedhimisht, më shumë të ardhura përmes mediave sociale⁴¹. Këshilli i Mediave ka mbi 50 anëtarë, ndërsa sipas disa artikujve të publikuar në media⁴², vlerësohet se aktualisht janë rreth 300 portale në Kosovë që ofrojnë informacione të ndryshme për qytetarët. Një sfidë është dallimi mes online mediave autentike dhe prodhuesve të ndryshëm të përmbajtjes online. Çështje të tjera me të cilat përballet vetërregullimi i mediave online janë video përmbajtjet e publikuara nga mediat online dhe komentet e prodhuara nga përdoruesit.⁴³

Në vitin 2015, Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës vendosi të përfshijë përmbajtjen e gjeneruar nga përdoruesit në Kod. Dispozitat për ndalimin e shpifjes, fyerjes, nxitjes së urrejtjes ose dhunës në bazë të racës, fesë dhe karakteristikave të tjera të mbrojtura ndalohen gjithashtu në komente dhe opinione sipas neneve. Ndryshimi i bërë nga Këshilli nuk u prit mirë nga shumë media. Mediat, pas një rezistence, gradualisht ndryshuan qasjen e tyre në moderimin e komenteve në portalet e tyre. Fillimisht, ata kërkonin që komentuesit të përfshinin emrat e tyre, emaillet dhe në disa media përdoruesit duhet të lidhnin profilet e tyre me llogaritë e mediave sociale për të komentuar në një artikull. Megjithatë, moderimi i komenteve ende paraqet vështirësi të shumta për mediat.

41 Intervistat me Muhamet Hajrullahun, Artan Mustafën dhe Labinot Lepshticën.

42 Betimi për Drejtësi, (2022), në dispozicion në: <https://betimiperdrejtesi.com/zeneli-mbi-300-medie-sjane-te-regjistruara-ne-kmshk/>.

43 Intervistë me Artan Mustafën, ligjërues në Kolegjin UBT në Departamentin e Sociologjisë, ish-kryeredaktor dhe gazetar për shumë vite, 1 qershor 2023, Prishtinë.

Për shembull, Kallxo.com ka një listë me 1000 fjalë që nuk lejohen në komente, por komentuesit shmangin fjalët e ndaluara duke përdorur pikësime të ndryshme. Sipas redaktorit të saj, ndalimi i plotë i komenteve do të çonte në kufizimin e lirisë së shprehjes, por fshirja e çdo komenti pa bazë të fortë mund të konsiderohet gjithashtu shkelje e lirisë së shprehjes.⁴⁴

Edhe pse Këshilli i Mediave pranoi ankesa në lidhje me komentet e bëra në rrjetet sociale në llogaritë e mediave të caktuara, ai nuk mund të ndërmarrë veprime pasi rrjetet sociale nuk janë në kompetencën e tij⁴⁵. Të intervistuarit theksojnë se mediat duhet të ndërmarrin hapa shtesë në moderimin e komenteve në llogaritë e tyre të mediave sociale dhe se mediat duhet të kenë një person përgjegjës për monitorimin e rrjeteve sociale dhe filtrimin e komenteve”.⁴⁶

“Kjo është e mundur sot, pasi komentet mund të bllokohen ose të hiqen. Prandaj, mediumi mund të jetë më vigjilent dhe të parandalojë individë të tillë nga përhapja e urrejtjes dhe shpifja ndaj palëve të përfshira në artikujt e mediave.” (Leposhtica).⁴⁷

Një sfidë tjetër është vetërregullimi i videove të publikuara nga mediat online⁴⁸, e cila ka qenë një detyrë sfiduese për KMSHK-në për shkak të kapaciteteve të kufizuara teknologjike. Këshilli i Mediave ka marrë disa ankesa në lidhje me prodhimet vizuale të mediave online, të cilat i ka adresuar në përputhje me Kodin e tij⁴⁹. Në shumë raste, këto prodhime vizuale fillimisht u transmetuan në stacione të ndryshme televizive në Kosovë dhe më vonë u publikuan online. Në raste të tilla, KMSHK-ja ka këshilluar palët që t'i drejtojnë ankesat e tyre në KPM.⁵⁰

44 Intervistë me Labinot Leposhticën, shef i zyrës ligjore në Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese në Kosovë, 9 qershor 2023, Prishtinë.

45 Intervistë me Imer Mushkolajn, drejtor ekzekutiv i KMSHK-së, gazetar dhe redaktor për një kohë të gjatë në media të ndryshme, 8 qershor 2023, Prishtinë.

46 Intervistë me Labinot Leposhticën, shef i zyrës ligjore në Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese në Kosovë, 9 qershor 2023, Prishtinë.

47 Intervistë me Labinot Leposhticën, shef i zyrës ligjore në Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese në Kosovë, 9 qershor 2023, Prishtinë.

48 Këshilli i Mediave të Shkuara të Kosovës, (2022), “Preambula e Kodit të Etikës” - pika e fundit e preambulës – “Këto rregulla zbatohen edhe për video storie të prodhuara/publikuara në mediat online”, në dispozicion në: <http://presscouncil-ks.org/kodi-i-mediave-te-skruara-dhe-online/>.

49 Intervista Nora Behlulin, Sekretare e KMSHK-së, 20 prill 2023, Prishtinë.

50 Ibid.

VI.

SFIDAT NË VETËRREGULLIMIN E TRANSMETUESIT PUBLIK

Përveç rregullave të KPM-së dhe atyre të përcaktuara në Ligjin për Transmetimin Publik, transmetuesi i shërbimit publik ka dokumentin e vet vetërregullues – Standardet Profesionale dhe Parimet Etike të Gazetarisë në Radio Televizionin e Kosovës⁵¹. Pavarësisht se nuk është shkruar shprehimisht në kodin e RTK-së, mosrespektimi i këtyre standardeve do të konsiderohet shkelje e detyrave të punës dhe mund të rezultojë në masa disiplinore për shkelësin.⁵²

Standardet Profesionale dhe Parimet Etike gjithashtu përfshijnë dispozita se si punonjësit e RTK-së duhet të sillen në mediat sociale, duke rekomanduar se çfarë duhet të ndjekin, si të shpërndajnë dhe si t'i pëlqejnë postimet ose fotografitë, dhe, mbi të gjitha, si t'u qasen çështjeve politike në raportimin e mediave dhe në mediat sociale që mund të rrezikojnë pavarësinë dhe politikën redaktoriale. Megjithatë, ai nuk respektohet gjithmonë, pasi disa gazetarë, redaktorë, madje edhe kryeredaktorë kanë shprehur hapur mendimet dhe preferencat e tyre politike në mediat sociale. Në disa raste, gazetarët ose redaktorët nga RTK-ja madje janë përfshirë në aktivitete politike.⁵³

Standardet Profesionale dhe Parimet Etike të RTK-së trajtojnë gjithashtu çështjen e komenteve dhe lejen e komenteve në webfaqen e RTK-së dhe faqen e RTK-së në Facebook. Sipas kodit, komentet që përmbajnë gjuhë të urrejtjes, shpifje ose fyerje duhet të hiqen nga administratorët e asaj faqeje të rrjetit social dhe pas heqjes, duhet të lihet një koment që shpjegon arsyen e fshirjes.⁵⁴

Standardet Profesionale dhe Parimet Etike gjithashtu përfshijnë dispozita se si punonjësit e RTK-së duhet të sillen në mediat sociale.

Sipas kodit, komentet që përmbajnë gjuhë të urrejtjes, shpifje ose fyerje duhet të hiqen nga administratorët e asaj faqeje të rrjetit social dhe pas heqjes, duhet të lihet një koment që shpjegon arsyen e fshirjes.

51 Radio Televizioni i Kosovës, (2015), "Standardet profesionale dhe parimet etike të gazetarisë në programet e Radio Televizionit të Kosovës", në dispozicion në: https://www.rtklive.com/pages/files/standardet_profesionale.pdf.

52 Gazeta Express, (2020), "Sindikata thotë se po ndëshkohen gazetarët e RTK-së në kohë pandemie, paralajmëron grevë e protesta" në dispozicion në: <https://www.gazetaexpress.com/sindikata-thote-se-po-ndeshkohen-gazetarët-e-rtk-se-ne-kohe-pandemie-paralajmëron-greve-e-protesta>.

53 Telegrafi.com, (2020), "Publikohen emrat e pjesëtarëve të Shërbimit Diplomatik të Kosovës që kanë lidhje me politikën", në dispozicion në: at: <https://telegrafi.com/debat-plus-prezanton-emrat-e-te-pjesetareve-te-sherbimit-diplomatik-te-kosoves-qe-kane-lidhje-politiken/>.

54 Radio Televizioni i Kosovës, (2015), Prishtinë, "Standardet profesionale dhe parimet etike të gazetarisë në programet e Radio Televizionit të Kosovës", neni 28 paragrafi 28.3, në dispozicion në: https://www.rtklive.com/pages/files/standardet_profesionale.pdf.

VII.

PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

Kosova ka një sistem funksional vetërregullues, por ka sfida të shumta në zbatimin e tij dhe rolin e tij në ngritjen e standardeve profesionale të mediave. Sfida kryesore për kornizën vetërregulluese në Kosovë është mungesa e qëndrueshmërisë financiare të Këshillit të Mediave. Sfida të tjera përfshijnë dallimin mes online mediave autentike dhe prodhuesve të ndryshëm të përmbajtjes online dhe zbatimin e vetërregullimit për video përmbajtjen e publikuar nga mediat online dhe për të përdorur përmbajtjen e gjeneruar. Për më tepër, përpjekjet e qeverisë së Kosovës për të imponuar rregullimin e mediave online përmes rregullave ligjërish të detyrueshme paraqesin kërcënime për ekzistencën e organit vetërregullues. Nevojitet përmirësimi i mekanizmit vetërregullues, gjetja e modelit të qëndrueshëm të financimit për Këshillin e Mediave dhe promovimi i punës së organit vetërregullues.

Rekomandime

- Këshilli i Mediave duhet të angazhohet në promovimin e kodit dhe punës së tij si në publik ashtu edhe në media. Ai duhet t'i vërë rregullisht vendimet në dispozicion të publikut.
- Këshilli i Mediave duhet të informojë vazhdimisht publikun për mundësinë e paraqitjes së ankesave në lidhje me shkeljet e mundshme të Kodit nga mediat online dhe të shkruara në Kosovë;
- Mediat duhet të marrin pjesë vazhdimisht në mbledhjet e Kuvendit të Këshillit dhe të kontribuojnë në punën e Këshillit të Mediave.
- Këshilli i Mediave duhet të bashkëpunojë ngushtë me Komisionin e Pavarur të Mediave për të rritur kapacitetet e tij në vendimmarrjen për video përmbajtjen e mediave online;
- Këshilli i Mediave, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës dhe Komisioni i Pavarur i Mediave duhet të bashkëpunojnë ngushtë me Ministrinë e Arsimit në prezantimin e arsimimit medial dhe edukimit në mediat sociale si pjesë e kurrikulave shkollore;

Sfida kryesore për kornizën vetërregulluese në Kosovë është mungesa e qëndrueshmërisë financiare të Këshillit të Mediave.

Nevojitet përmirësimi i mekanizmit vetërregullues, gjetja e modelit të qëndrueshëm të financimit për Këshillin e Mediave dhe promovimi i punës së organit vetërregullues.

- Komisioni i Pavarur i Mediave duhet të bashkëpunojë me mediat transmetuese për hartimin e kodit të ri të etikës për mediat transmetuese, duke përfshirë përditësimet më të fundit nga zhvillimet në legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar.
- Radio Televizioni i Kosovës duhet të iniciojë procedurën e rishikimit dhe përditësimin të kodit të brendshëm të etikës, duke përfshirë përditësimet më të fundit nga zhvillimet në legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar;
- Mediat duhet t'i trajtojnë vazhdimisht gazetarët në respektimin e Kodit të Etikës, qoftë në shtyp, online ose në transmetim. Ato duhet të promovojnë përdorimin e Kodit të Mediave të Shkruara dhe Online në redaksitë e tyre.

LITERATURA DHE BURIMET

Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, 2006. [Online] Gjetet në: http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L65_en.pdf.

Komisioni i Pavarur i Mediave. (2016). "Kodi i etikës për ofruesit e shërbimeve mediatike në Republikën e Kosovës." [Online] Gjetet në: <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/1476189555.8908.pdf>.

Kusari, F. (2018). "Ligji për media: i panevojshëm". [Online] Në dispozicion në: <https://sbunker.net/article10-bllogje-tematike/89706/ligji-per-media-i-panevojshem/>.

Kosovo 2.0. (2015). Liria e Shprehjes, Mediave dhe Informimit në Kosovë: Një Vlerësim i Bazuar në Treguesit e Këshillit të Evropës për Mediat në Demokraci. Prishtinë. [Online] Gjetet në: https://crd.org/wp-content/uploads/2018/12/Freedom_of_Expression_Media_and_Information_in_Kosovo_529396.pdf.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, 2009, Kapitulli VIII Media gjatë fushatës zgjedhore nga neni 47 deri në nenin 53. [Online] Gjetet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2544>.

Mehmeti, J. (2022). "Barometri vibrant i informacionit". [Online] Në dispozicion në: https://www.irex.org/VIBE_2022_Kosovo.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. (2012). Ligji Nr. 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës. Prishtinë. [Online] Gjetet në: https://cps.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/09/LAW_NO_04_L-046_ON_RADIO_TELEVISION_OF_KOSOVO.pdf.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. (2008). Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Prishtinë. [Online] Gjetet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2544>.

Schroeder, R. (2018). "Examining and Assessing Editorial Guidelines/Codes of Conducts in the Public Service Media of the Western Balkans." [Online] Gjetet në: <https://europeanjournalists.org/wp-content/uploads/2018/07/PSM-Editorial-Guidelines-Report-EFJ-Renate-Schroeder.pdf>.

LISTA E INTERVISTAVE

Artan Mustafa, ligjërues në UBT – Universiteti për Biznes dhe Teknologji, Departamenti i Sociologjisë, 1 qershor 2023, Prishtinë.

Besnik Boletini, kryetar i Bordit të RTK-së, gazetar në Preportr, 14 qershor 2023, Prishtinë.

Flutura Kusari, këshilltare e lartë ligjore në ECPMF - Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias, 7 qershor 2023, Prishtinë.

Imer Mushkolaj, drejtor ekzekutiv i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, 8 qershor 2023, Prishtinë.

Labinot Leposhtica, shef i zyrës ligjore të BIRN-it Kosovë, 9 qershor 2023, Prishtinë.

Muhamet Hajrullahu, kryeredaktor i Telegrafi.com, ligjërues në UBT – Universiteti për Biznes dhe Teknologji, 4 qershor 2023, Prishtinë.

Nora Behluli, sekretare e Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, Prishtinë, 20 prill 2023.

RRETH AUTORIT

Florent Spahija është profesionist ligjor me ekspertizë në fushat e legjislacionit, antikorrupsionit dhe lirisë së mediave. Florenti ka titullin master në të Drejtën Civile nga Universiteti i Prishtinës. Ai ka shërbyer si këshilltar ligjor në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës dhe në Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë. Ai gjithashtu ka punuar për Transparency International, Fondin për të Drejtën Humanitare dhe Rrjetin Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese (BIRN).

KAPACITETET E KUFIZUARA DHE MUNGESA E QËNDRUESHMËRISË

Vetërregullimi i mediave në Kosovë

Ky publikim realizohet në kuadër të hulumtimit të kryer si pjesë e projektit “Media jonë: Projekt i shoqërisë civile për nxitjen e edukimit medial dhe aktivizmit, kundër polarizimit, në dobi të dialogut.” Seria e parë e hulumtimit u realizua në kuadrin tematik me titull “Analiza kritike e kodeve etike dhe vetërregullimi i mediave në Shqipëri, Bosnjë e Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi dhe Turqi”.

Projekti “Media jonë: Projekt i shoqërisë civile për nxitjen e edukimit medial dhe aktivizmit, kundër polarizimit, në dobi të dialogut” zbatohet bashkërisht nga nëntë organizata për zhvillimin e mediave nga Ballkani Perëndimor dhe Turqia me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Koordinator i projektit trevjeçar është Fondacioni Mediacentar Sarajevo. Partnerë në projekt janë Instituti Shqiptar i Medias në Tiranë; Bianet në Stamboll; Instituti Maqedonas për Media në Shkup; Instituti i Malit të Zi për Media në Podgoricë; Shkolla e Gazetarisë në Novi Sad; Instituti i Paqes në Lubjanë; Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në Prishtinë; dhe Rrjeti i Evropës Juglindore për Profesionalizimin e Mediave (SEENPM).